



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:201261

Datë: 30.03.2024

Numri i dokumentit: 05528830

C.nr.921/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore të paditëses H.Th nga fshati Çifllak, Komuna e Rahovecit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.D nga Prishtina, ndaj të paditurës E me seli në Prishtinë, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, me vlerën e objektit të kontestit prej 3,745.00 euro, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 20.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditëses H.Th nga fshati Çifllak, Komuna e Rahovecit.

II. DETYROHET e paditura E me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut më datën 30.06.2021 në fshatin Dobidol, Komuna e Rahovecit, paditësen H.Th në emër të dëmit jo material ta kompensojë dhe atë:

- Në emër të dhimbjeve fizike.....1,300.00 euro.
- Në emër të frikës së përjetuar.....1,000.00 euro.

Të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 2,300.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimit, e deri në pagesën definitive, e në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura S me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut më datën 08.02.2020 në fshatin Dobidol, Komuna e Rahovecit, paditësen H.S, në emër të dëmit material ta kompensojë dhe atë:

- Në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë.....98.00 euro.
- Në emër të ushqimit të përforcuar (30 ditë).....147.00 euro.

Të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 245.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data 03.09.2021 (data e parashtrimit të padisë), e deri në pagesën definitive, e në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim.

IV. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses H.Th, përtej shumës së aprovuar si në pikën II, dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

V. DETYROHET e paditura P me seli në Prishtinë, që paditëses H.Th t'ia paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej 839.00 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

#### A r s y e t i m

Paditësja H.Th, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, më datën 21.09.2023 në këtë gjykata ka parashtruar padinë ndaj të paditurës E me seli në Prishtinë, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, me vlerën e objektit të kontestit prej 3,700.00 euro, e precizuar me parashtresën e datës 17.01.2024.

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka theksuar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë së parashtruar. Meqenëse baza juridike nuk është kontestuese, propozoj që të caktohet nxjerrja e provës me ekspertizë mjekësore nga lëmi i ortopedisë – traumatologjisë dhe psikiatrisë, detyrë e të cilëve do të jetë që pas shikimit të shkresave të lëndës dhe ekzaminimit të palës paditëse të japin mendimin e tyre të përbashkët për natyrën e lëndimeve dhe format e kërkuara si në kërkesëpadi, për ortoped ka propozuar Dr. Xh.S, ndërsa për psikiatër Dr. V.B.R. Pas pranimit të ekspertizës ka deklaruar se ndaj të njëjtës nuk kanë vërejte dhe nuk kërkojnë që ekspertet – hartuesit e kësaj ekspertizë të japin sqarime shtesë, si dhe duke u bazuar në mendimet e konstatimet e eksperteve, ka bërë precizimin kërkesëpadisë përmes parashtresës të cilën e ka dorëzuar në gjykatë me precizim. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e precizuar ta aprovoj në tërësi si të bazuar, pasi që e njëjta gjenë mbështetje në provat e administruara nga ana e gjykatës, si dhe njëjta është në përputhje me dispozitat ligjore të LMD-së, Udhëzimin e Gjykatës Supreme, të datës 27.02.2023, praktikën gjyqësore, ndërsa lartësia e saj është e bazuar dhe e mbështetur në ekspertizën mjekësore të punuar nga Dr. Xh.S dhe Dr. V.B.R. Po ashtu gjykatës i ka propozuar që lartësia e shumave të precizuara të paguhet me kamatë vjetore me lartësi prej 8%, bazuar në nenin 382 të LMD-së, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë, deri në pagesën përfundimtare.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës F.H, në përgjigjen në padi, në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklarimeve të deritanishme. Duke shtuar se për të paditurën nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, ndërsa sa i përket lartësisë nuk kemi mundur të deklarohe mi pasi që e paditura ka kërkuar nga paditësja dokumente shtesë siç janë raportet mjekësore të vërtetuara ose origjinale, raportin e emergjencë, pasi që paditësja nuk i ka dorëzuar te e paditura dokumentet e kërkuara, e kështu e ka pamundësuar dërgimin e një oferte. Sa i përket propozimeve të përfaqësuesit të paditëses për nxjerrjen e provave me ekspertiza mjekësore të njëjtat në parim nuk i ka kundërshtuar, por i është lënë në vlerësim të gjykatës. I njëjti ka theksuar se ekspertizat mjeko ligjore nga lëmia e psikiatrisë dhe ortopedisë – traumatologjisë, i kanë pranuar, ndërsa ndaj të njëjtave kanë vërejtjen, ndërsa gjykatës i propozoi që në seancën e radhës të ftohen ekspertet për ti parashtruar pyetjet në lidhje me ekspertizat.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata ka lejuar ndryshimin e kërkesëpadisë në kuptimin objektiv, konform nenit 258.1 të LPK-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 23.02.2024, sipas propozimit të palëve ka administruar provat dhe atë: Raportin policor të aksidentit, të datës 30.06.2021, me numër serik 315437, i lëshuar nga Stacioni Policor Gjakovë (numri i raportit nuk dallohet); raport nga konsulta, i datës 01.07.2021, me faksimil të Dr. M.H; fletëlëshimi, me numër të historisë 549, i Repartit Kirurgjik të Spitalit të Përgjithshëm “Isa Grezda”, në Gjakovë; raporti specialistik, i datës 05.07.2021, me vulë të Spitalit të Përgjithshëm “Isa Grezda”, në Gjakovë dhe faksimil të Dr. N.R; udhëzimi për konsultim me numër serik 0016174, i datës 05.07.2021, me faksimil të Dr. A.H; raporti nga konsulta, i datës 05.07.2021, me vulë të Spitalit të Përgjithshëm “Isa Grezda”, në Gjakovë dhe faksimil të Dr. S.B; udhëzimi për konsultim me numër serik 0016175, i datës 05.07.2021, me faksimil të Dr. A.H; raport nga konsulta, i datës 05.07.2021, me vulë të Spitalit të Përgjithshëm “Isa Grezda”, në Gjakovë dhe faksimil të Dr. B.R; raporti kthyes nga diagnostika, me numër serik 0038420, i datës 21.03.2022, me faksimil të Dr. M.L; raportin nga konsulta, i datës 01.04.2022, me vulë të Spitalit të Përgjithshëm “Isa Grezda”, në Gjakovë dhe faksimil të Dr. M.L; raportin nga konsulta, i datës 18.03.2022, me vulë të Spitalit të Përgjithshëm “Isa Grezda”, në Gjakovë dhe faksimil të Dr. M.L; udhëzimin për konsultim me numër serik 008429, i datës 17.03.2022, me faksimil të Dr. A.S dhe ekspertizë mjekësore për H.Th, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 12.12.2023 dhe e punuar nga Dr. Xh.S dhe Dr. V.B.R.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 7 dhe 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Ndërmjet palëve nuk ishte kontestues fakti se me datën 30.06.2021, rreth orës 09:30 min, në fshatin Çifllak, Komuna e Rahovecit, është shkaktuar aksidenti i trafikut me dëme materiale dhe jo materiale ndërmjet paditësit dhe të siguruarit të paditëses. I cili fakt është vërtetuar sipas raportit Policor të datës 30.06.2021, të Stacionit Policor Gjakovë.

Në këtë çështje kontestimore ndërmjet palëve kontestuese është lartësia e kërkesës së paditëses në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material.

Me administrimin e raportit policor të datës 30.06.2021, të Stacionit Policor në Gjakovë, gjykata vërtetoi faktin se deri te aksidenti i trafikut të datës 30.06.2021ka ardhur për shkak të lëshimeve të ngasësit të veturës të markës O, me targa të regjistrimit ..., i siguruar tek e paditura

Me administrimin e mendimit e përbashkët të ekspertit të ortopedisë dhe traumatologjisë Dr. Xh.S dhe ekspertes psikiatër Dr. V.B.R të dorëzuar në gjykatë me datën 12.12.2023 dhe sqarimeve të këtyre eksperteve në seancën e datës 20.03.2024, (të cilit gjykata ia dha besimin e plot) gjykata vërtetoi faktin duke u bazuar në raportet mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses me datën 23.11.2023, paditësja në aksidentin e datës 30.06.2021 ka pësuar këto lëndime trupore: ndrydhje e qafës, gërvishtje të bërrylit të djathtë dhe ndrydhje të gjurit të djathtë, lëndime të cilët konsiderohen si lëndime të lehta trupore. Këto lëndime paditëses i kanë shkaktuar: dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rënd, të cilat kanë zgjatur 15 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rënd, të cilat kanë zgjatur për 24 orë, kohë pas

kohe deri në veprimin e terapisë kundër dhimbjes, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm, të cilat kanë zgjatur 14 ditë, si dhe dhimbje fizike të intensitetit të ulët, të cilat të cilat vazhdojnë ende, e që manifestohen me dhimbje të qafës, të gjurit, marramendje, ndjenja e të vjellurit e shoqëruar me dhimbje koke. Ndërsa sa i përket frikës e njëjta ka pësuar: frikë primare, që ka zgjatur disa sekonda, në momentin e perceptimit të rrezikut të drejtpërdrejt për jetën, prej momentit të goditjes nga automjeti, zhvendosjes fizike të automjeti ku e njëjta është ndodhur, e deri te ndalja përfundimtare e tij, kur edhe ka kaluar rreziku i drejtpërdrejtë për jetën, e cila frikë cilësohet si frikë nga përfundimi fatal – vdekja. Frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur për 24 orë pas aksidentit, si reaksion akut në stres, e shfaqur me reagime emocionale, ankth dhe shqetësime për pasojat e mundshme nga aksidenti, bazuar në mënyrën si ka ndodhur aksidenti dhe moshën e saj. Frikë sekondare e intensitetit të mesëm, e cila ka zgjatur për 6 javë, me rikujtim të ngjarjes traumatike, gjumë jo të rehatshëm, dhimbje të herë pas hershme në regjionet e atakuara në aksident, është e brengosur dhe e preokupuar se mos ky aksident do ti lë pasojat shëndetësore në të ardhmen, bazuar edhe në moshën e saj. Për shkak të gjendjes së lartcekur, si dhe ankthit kokë dhimbjes dhe marramendjes, e njëjta ka kërkuar ndihmën e mjekut psikiatër dhe neurolog, të cilët i kanë përshkruar terapi adekuate. Frike sekondare të intensitetit të ulët ende, herë pas here të manifestuar me frikë, ankth, dhe pasiguri gjatë pjesëmarrjes në komunikacion dhe në situata të ngjajshme me atë aksident. Po ashtu sipas këtyre ekspertizave është konstatuar se paditësja në aksidentin e trafikut nuk ka pësuar zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtim trupor. Ndihma e personit tjetër ka zgjatur për 14 ditë, ndihme e cila konsiston në përgatitjen dhe ofrimin e ushqimit, mbajtjen e higjienës personale, si dhe disa ndihmesave tjera ditore. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 21ditë, i pasur me minerale, vitamina proteina dhe alumbina, si dhe Rehabilitimi fizioterapeutik – klimatik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 14 ditë, të ndara në dy seanca nga 7 ditë për vitin e parë pas aksidentit, në raport me moshën.

Gjykata vendosi ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit për faktin se sipas vlerësimit të saj në këtë çështje juridike kontestimore kemi të bëjmë me shkaktimin e dëmit material dhe jo material, si pasojë e aksidentit të komunikacionit i shkaktuar si rezultat i lëshimeve të të siguruarit të të paditurës, e që nuk është kontestuar edhe nga e njëjta. Baza juridike e kërkesëpadisë buron nga neni 136 i LMD-së, ku parashihet se *“Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Ndërsa neni 140 e të njëjtit ligj parasheh se *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*. Po ashtu, në nenin 159 par. 1 të LMD-së *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”*.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë në lidhje me dëmin jomaterial, gjykata ka vendosur që këto lëndime trupore të i trajtojë si lëndime të lehta trupore për shkakun se nga ekspertiza e ekspertit ortoped – traumatolog, Dr. Xh.S, këto lëndime janë kategorizuar si lëndime të lehta trupore. Në këtë rast, gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi për faktin se shumata e vendosura të jenë një satisfaksion për paditësin dhe se këto shuma janë vendosur në pajtueshmëri të plotë me praktikën gjyqësore. Në këtë rast, gjykata vendosi ta aprovojë kërkesëpadinë në emër të dhimbjeve fizike në shumën prej 1,300.00 euro, për shkak se lëndimet e marra nga paditësi në këtë aksident cilësohen si lëndime të lehta trupore, e në bazë të

ekspertizës, paditësi dhimbjet fizike me intensitet posaçërisht të rëndë ka pasur për 15 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë kanë zgjatur për 24 orë, dhimbjet fizike të intensitetit të mesëm kanë zgjatur për 24 orë dhe dhimbje fizike të intensitetit më të ulët vazhdojnë kohe pas kohe.

Gjithashtu, gjykata vendosi ta aprovojë kërkesëpadinë në emër të frikës së përjetuar në shumën prej 1,000.00 euro për shkak se paditësja në momentin e aksidentit ka përjetuar frikë që ka zgjatur disa sekonda, e cila frikë cilësohet si frikë nga përfundimi fatal – vdekja. Frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur për 24 orë pas aksidentit, e shfaqur me reagime emocionale, ankth dhe shqetësime për pasojat e mundshme nga aksidenti, bazuar në mënyrën si ka ndodhur aksidenti dhe moshën e saj. Frikë sekondare e intensitetit të mesëm, e cila ka zgjatur për 6 javë, me rikujtim të ngjarjes traumatike, gjumë jo të rehatshëm, dhimbje të herë pas herë në regjionet e atakuara në aksident, është e brengosur dhe e preokupuar se mos ky aksident do ti lë pasojat shëndetësore në të ardhmen. Për shkak të gjendjes së lartcekur, si dhe ankthit kokë dhimbjes dhe marramendjes, e njëjta ka kërkuar ndihmën e mjekut psikiatër dhe neurolog, të cilët i kanë përshkruar terapi adekuate. Frike sekondare të intensitetit të ulët ende, herë pas here të manifestuar me frikë, ankth, dhe pasiguri gjatë pjesëmarrjes në komunikacion dhe në situata të ngjajshme me atë aksident. Baza juridike e vendosjes në lidhje me lartësinë e shpërblimit buron në nenin 183 par.1 të LMD-së, sipas të cilit *“Për dhembjet e pësuarat fizike, për dhembjet e pësuarat shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”*, ndërkaq sipas nenit 174 të LMD-së përcaktohet që *“Gjykata duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkakimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues”*. Me rastin e vendosjes në lidhje me lartësinë e shpërblimit të dëmit, gjykata kishte parasysh edhe shkallën e dëmit që i është shkaktuar paditëses, ndërsa kjo buron në nenin 183 par.2 të LMD-së, sipas të cilit *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Për të gjitha këto kategori, duke u bazuar në ekspertizat mjekësore, për shpërblimin e dëmit në rastin konkret gjykata ka vendosur sipas çmuarjes së lirë, e kjo duke u bazuar në nenin 323 të LPK-së, sipas të cilit *“Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t’i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë”*. Lidhur me kamatën, kjo gjykatë është mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Sa i përket dëmit material, gjykata ka vendosur që ta aprovojë kërkesëpadinë deri në shumën prej 245.00 euro dhe atë në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë shumën 98.00 euro euro, në emër të ushqimit të përforcuar (21 ditë) shumën prej 147.00 euro. Gjykata me rastin e

vendosje po ashtu ka marr për bazë edhe tërë dokumentacionit mjekësor që i janë bashkangjitur shkresave të lëndë.

Gjykata ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit për faktin se sipas vlerësimit të saj me shumat e aprovuara në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, arrihet satisfaksioni i nevojshëm në lidhje me dëmin që i është shkaktuar paditësit në aksidentin që është objekt i këtij kontesti. Vlerat e aprovuara janë në harmoni të plotë me pritshmërinë e krijuar në rastin konkret, prandaj edhe ka vendosur që ta refuzojë shumën përtej shumës së aprovuar. Me rastin e vendosjes, gjykata pati për bazë shkallën e lëndimit, natyrën e lëndimit, moshën e paditëses që në rastin konkret është e dëmtuar, por që shuma e kërkuar është dukshëm më e lartë nga ajo që gjykata vlerëson se në rastin konkret do të jetë satisfaksion për dëmin e shkaktuar.

Gjykata ka analizuar edhe provat tjera dhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, mirëpo të njëjtat nuk kanë impakt në vendosjen ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me lartësinë e kamatës është marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë, e duke u bazuar në dispozita të neneve 136, 140, 159 dhe 183 të LMD-së, vlerësojë se e paditura është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar paditëses me rastin e shkaktimit në aksidentin e trafikut, dhe duke u mbështetur në dispozitat e neneve 143, 323, dhe 390 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimin në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata e morri duke u mbështetur në dispozitat e neneve 449 dhe 450.2 të LPK-së në bazë të suksesit në kontest, përpilimin e parashtresave dhe përfaqësimet në seancë sipas vlerës së kërkesëpadisë të aprovuar.

Nga të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr.921/2021, më datë 20.03.2024

Gjyqtari  
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.